POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1
U godit me sende të forta nga klienti, ndërron jetë në spital pas 5 ditësh kamarieri në Elbasan! Sherri nisi për një tavolinë të rezervuar

2
Apartament, tokë në Yzberisht dhe disa makina dhe kredi! Kjo është pasuria e drejtorit të ri të Policisë së Shtetit Gledis Nano

3
Hoxha me biznese, Elvis Naçi: Spitalin do ia shes Kryegjyshatës Botërore Bektashiane për 850 milionë lekë, paratë do i përdor për të zgjidhur hallet e shqiptarëve

4
Gjermani/ Humbja fatale e kandidatit kryesor të Merkel, Laschet pritet të japë dorëheqjen

5
E reja ndërroi jetë në spitalin e Vlorës pas një operacioni, i ati: S'më kishte thënë se ishte sëmurë, akoma nuk më kanë dhënë përgjigje pse vdiq! 2 Fëmijët që la pas kërkojnë të ëmën

Kronikë

Atentat në Elbasan, dy të vdekur! Viktimat me precedent penal, njëri i lidhur me Talo Çelën, tjetri i hetuar për vrasjen e Everest Çakaj! Gjendet i djegur në Balldre automjeti i autorëve

Krimi ka tronditur sërish Elbasanin, ku një atentat i mirëorganizuar ka shënuar 2 viktima. Ngjarja u regjistrua në Bradashesh, në vendin e quajtur rrethrrotullimi i luleve, pranë një karburanti, ku viktimë në vendin e ngjarjes mbeti Lulzim Bitri dhe Ardian Çollaku, i cili ndërroi jetë në spital

■ Atentati në Elbasan ndaj Lulzim Bitrit dhe Ardian Çollakut, dalin foto dhe video e automjetit që përdorën autorët, i vunë flakën në fshatin Balldre
■ VIDEO/ Atentati në Elbasan, Ardian Çollakun pësoi vdekje klinike, dërgohet te Trauma në Tiranë
■ Atentati në Elbasan, kush është Ardian Çollaku, i dënuar me mbi 23 vite burg në Itali për prostitucion dhe subjekt i OFL
■ Atentati në Elbasan, identifikohet viktima tjetër, i përfshirë në një vrasje në Tetovë

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Sokol Dema

Ronaldo Gjoshi

4 Tetor, 19:25 | Përditesimi i fundit: 5 Tetor, 11:15

A+ A-

ELBASAN- Krimi ka tronditur sërish Elbasanin, ku një atentat i mirëorganizuar ka shënuar 2 viktima. Ngjarja u regjistrua në Bradashesh, në vendin e quajtur rrethrrotullimi i luleve, pranë një karburanti, ku viktimë në vendin e ngjarjes mbeti Lulzim Bitri dhe Ardian Çollaku, i cili ndërroi jetë në spital.

Çollaku bashkë me Bitrin, kanë qenë duke lëvizur në këmbë, në momentin që janë qëlluar me breshëri kallashnikovi nga një automjet në lëvizje. Plumbat i morën jetën në vend Bitrit, ndërsa Çollaku mbeti i plagosur rëndë, por ndërroi jetë në spital. Automjeti, tip 'Volvo' i përdorur nga autorët u gjet i djegur disa minuta më pas në fshatin Balldre, një skemë e përsëritur nga ekzekutorët edhe në atentate të tjera të ndodhura në vend.

LEXO EDHE:

Belsh/ Aksident, mjeti ka humbur kontrollin nga lagështia në rrugë! 2 persona shoqërohen në spital

Kamerat e sigurisë së karburantit pritet të zbardhin më shumë detaje si ndodh ngjarja, ndërsa policia ka ngritur postblloqe në hyrje dhe në dalje të qytetit. Në Elbasan kanë mbërritur edhe forcat RENEA, FNSH dhe Departamenti i Policisë Kriminale.

Po kush janë dy shënjestrat e këtij sulmi mafioz?

Rezulton se si Bitri dhe Çollaku kanë qenë persona me precedentë të mëparshëm penal dhe me lidhje me bandat që veprojnë në Elbasan. Ardian Çollaku, i njohur edhe si Ardian Subashi, u hetua si i lidhur drejtëpërdrejtë me vrasjen e ***Everest Çakës*** në maj të këtij viti. Ndërkohë, në vitin 2015 është arrestuar në Elbasan pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritet italiane, që e kishin dënuar atë me mbi 23 vjet burg për "Shfrytëzimit të prostitucionit" dhe "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje e armeve luftarake dhe e municionit". Subashi ka qenë edhe subjekt i OFL ku vitin e kaluar së bashku me 3 persona të tjerë iu kërkua deklarimi i pasurisë.

Lulzim Bitri rezulton mik i ngushtë i ***Talo Çelës***, teksa në vitin 2018 u arrestua, i akuzuar për vrasje në bashkëpunim të një personi në Tetovë të Maqedonisë së Veriut. Vrasja ndodhi pas përplasjes mes dy grupeve kriminale. Ka dyshime se vrasja e dyfishtë mund të ketë ndodhur për larje hesapesh, por hetimet vijojnë ende.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 23:11

Atentati në Elbasan ndaj Lulzim Bitrit dhe Ardian Çollakut, dalin foto dhe video e automjetit që përdorën autorët, i vunë flakën në fshatin Balldre

Report Tv ka siguruar foto dhe video të automjetit tip 'Volvo' që përdorën autorët në atentatin ndaj Lulzim Bitrit dhe Ardian Çollakut dhe që më pas u vunë flakën në fshain Balldre, për të fshehur gjurmët. Sikurse mund të shihni dhe në foto, automjeti, i rrethuar me rreth të kuq, është shkrumbuar tërësisht, ndërsa grupi hetimor ndodhet në vendngjarje për të mbledhur provat që mund të kenë mbetur.

[Shqiptarja.com]

Rrethuar me rreth të kuq automjeti i djegur i autorëve

Ora 21:30

Iu bë atentat mbrëmjen e sotme në Elbasan, Lulzim Bitri lidhje të ngushta me Talo Çelën! Ardian Çollaku i hetuar për vrasjen e Everest Çakaj 6 muaj më parë

Lulzim Bitri dhe Ardian Çollaku, të cilët ranë pre e një atentati mbrëmjen e sotme në Elbasan, rezultojnë pjesë e grupeve kriminale në këtë qytet. Bëhet me dije se Lulzim Bitri kishte lidhje të ngushta me ***Talo Çelën***, i shpallur në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar, pasi akuzohet për vrasjen e ***vëllezërve Haxhiaj*** si dhe për grabitjen në Rinas.

Ndërkohë rezulton se Ardian Çollaku (Subashi), i cili ndodhet në gjendje të rëndë në spitalin e Traumës, është hetuar për vrasjen e ***Everest Çakës***, ngjarje e ndodhur më 11 maj të këtij viti, ku dyshohet se Çakaj ka patur lidhje direkte në ekzekutimin. Po ashtu bëhet me dije se pas dënimit në Itali, Çollaku nuk u shkëput nga veprimtaria kriminale, ndërsa vidhte automjete dhe ua shiste grupeve kriminale për të kryer vrasje.

Ka dyshime se ai ka bashkëpunuar edhe me grupin e Dubait dhe të Erion Alibejt, i cili është vëllai i ***Endrit Alibejt***, që mbeti i vrarë më 29 dhjetor 2018 në Bradashesh.

Lulzim Bitri ndërroi jetë mbrëmjen e sotme, ndërsa Ardian Çollaku mbeti i plagosu rëndë, pasi u qëlluan me breshëri automatiku në Bradashesh, në vendin e quajtur rrethrrotullimi i luleve. Dyshohet se ata janë vrarë për larje hesapesh, por hetimet vijojnë ende për të hedhur më shumë dritë mbi ngjarjen.

Ora 20:53

VIDEO/ Atentati në Elbasan, Ardian Çollakun pësoi vdekje klinike, dërgohet te Trauma në Tiranë

Ardian Çollaku, 48 vjeç, mbeti i plagosur nga atentati në Elbasan në zonën e njohur si rrethrrotullim i Luleve. Ai është dërguar në spitalin e Elbasanit ku ka pësuar vdekje klinike dhe është nisur drejt Tiranës, ku ka mbërritur në spitalin e Traumës

Ora 20:00

Atentati në Elbasan, identifikohet viktima tjetër, i përfshirë në një vrasje në Tetovë

Report Tv ka mësuar emrin e viktimës së dytë nga atentati në Elbasan, i cili është identifikuar si Lulzim Bitri 43-vjeçari, nga Elbasani. Edhe ky ishte një person me precedent të mëparshëm penal, pasi akuzohej për vrasjen e një personi në Tetovë të Maqedonisë së veriut në 2018. Vrasja ndodhi pas përplasjes mes dy grupeve kriminale.

Ora 19:47

Atentati në Elbasan, kush është Ardian Çollaku, i dënuar me mbi 23 vite burg në Itali për prostitucion dhe subjekt i OFL

Report TV mëson se personi i plagosur rëndë në atentatin në Elbasan është Ardian Çollaku. Ky emër nuk është i panjohur për policinë, pasi më parë ka vuajtur dënimin për prostitucion dhe armëmbajtje pa leje në Itali. Ardian Subashi Çollaku, 48 vjeç , u dërgua në spitalin e Elbasanit, por ka pësuar vdekje klinike dhe po dërgohet në Tiranë. Ardian Subashi (Çollaku) ka qenë edhe subjekt i OFL-së.

Kush është Ardian Subashi (Çollaku)? Në 2015 ai ishte arrestuar në Elbasan me qëllim ekstradimin në Itali. Autoritet italiane e kishin dënuar atë me mbi 23 vjet burg për veprat penale te "Shfrytëzimit të prostitucionit" dhe "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje e armeve luftarake dhe e municionit". Është ende e paqartë nëse Çollaku është ekstraduar apo jo drejt Italisë.

J.SH./r.k./Shqiptarja.com

TAG: elbasan vrasje fnsh Renea ardian collaku lulzim bitri

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
I kujt është faji për ngecjen e integrimit të Shqipërisë në BE?

I qeverisë | I BE | Nuk e di

Komento

Komente

Altini Meleqit: 05/10/2021 18:39

Vlora ka djem nenash qe te heqin dhe se mer vesh.Luani Tines dhe Nar Musta me Ardin e Faikas te groposin te gjall dhe kur vete bari 7 metra thon njerzit cu ben kta

Përgjigju

fieri: 05/10/2021 20:04

ahahhaaha ore po ti u bere xheloz ti po dale ne 2021 ne vlor jan vrar 5 veta e jan plagos 4 aty aty esht ndeshja elbasan vlor ahhahaha

Qelbasanlliu: 05/10/2021 07:18

Ore ju merreni me fjale tavoline apo se kuptoj... Ardjan collaku ka ikur qe ne 94-95 me femer ne fillim si TE gjithe pastaj nga 1999 e deri nga 2005 me Potter-Al Hollander gjermani itali Belgium... Ka blere prona pa fund me leket ska qen kurre keq edhe gjithmone qaheshe se ate lloj metode kishte jam keq jam keq... Por ka pasur mbi 1 milion euro prona... Ne 2017 shtypi njerin tek bulevardi kryesor edhe beri ja 3 vjet+/- burg. Por te degjosh me bandat apo hajdut makinash me fjale tavoline habitem. Jashtezakonisht e pa tolerueshme. Apo me bandat!? I vetmi person qe nuk ka pasur probleme me asnje edhe me te gjithe shok e miq... Nuk eshte mbajtur as per I forte as I keq. Gjithsesi per te gjithe kuriozet edhe ato qe degjojne fjale tavoline kjo eshte e verteta e Tij... Nje person qe eshte marr me pislleqe edhe qe rrinte ne distance nga sherret edhe problemet...

Përgjigju

hasoni: 06/10/2021 07:29

Me kete vendimin e pafajsise na e mbushe mendjen.Pse nuk e dime ne gjendjen e gjykates se Elb.Ai u arrestua per tu ekstraduar ne Itali dhe gjykata e pengoi.Pasi po te ishte ekstraduar do ishte gjalle.Sa per ate qe thua,po dilte ne kembe por i arusha Mira qe rrinte sa rrinte dhe rrotullohej.Me hije ishte.Ai burri qe beri 20 vjet burg se vrau vellain e atyre te Deltes me duket se ka dale nga burgu.Sebepi ti Turi e di kush ishte.Po ashtu u vra dhe Everesti para ca kohesh dhe dihet qe Ardiani mori pjese.Po u ngaterrove me pislleqe do te vij koha edhe ty.Sa per leket qe kishte le ti marri me vehte .

Turiel: 05/10/2021 09:17

O bobi ti bobi se pse u vra ai aty ka qen gjithe kohes edhe delta aty kan qen pse skan bere hap perpara... As makine te blinduar ska pasur asgje. Ne kembe dilte ne darke si lala qazimi qe Jo do e vrasin Jo do e bejne... O bobush din ku bejne njerezit nuk eshte aq e thjesht me terhequr kembezen... Puna makinave ke te drejte por ik e pyet ne gjykate me duket se ka vendim pafajesie nuk ishte ai qe I digjte I vellai me duket... Keshtu qe lejini njerezit rehat se duke fol ti e duke fol CA te tjere e beni lemsh kete popull injorant e duke degjuar biseda tavoline... Ai bishe ka qen gjithmone I karikuar me leke gjithmone...

Bobi: 05/10/2021 08:15

Te drejte ke nuk merrej me vjedhje por me djegie makinash me benzine. Kush kishte makina te reja ku I vinte flaken si skuth qe eshte. Eshte super intrigant mqs e njifke ti. Prej ketij eshte vrare 1 nga vellezerit e Luanit, Qazimit dhe Bujarit qe kane pllakat Delta group. Ishte nana e intriges. Shume e zgjati dhe kaq po qe se ja hedh dhe kete here prap aty e ka. Ky Stan ate bulmet ka. Me pak fjale po e mbyll me thenien e filmit perballimi. U qerua qyteti dhe nga nje bajge

Kapteri: 05/10/2021 02:24

Bone boni si garipa,,,se si qen te ngordhet do ju HEDHIN neper gerneta mor laskuriqen.....

Përgjigju

Pashe fola ika...: 05/10/2021 02:20

Mos u merrni me pislleqe I themi te rinjve te elbasanit dhe gjithe shqiperise,,,,ndryshe do hani dhe..si keta te sotmit...

Përgjigju

bravo more trima..: 05/10/2021 00:40

Dy mutra më pak nga kanali mutit me emrin Elbasan

Përgjigju

Tony montona: 04/10/2021 21:51

Po ke shkelur ne kallo , do tvi ora e dita ..

Përgjigju

Labi: 04/10/2021 21:45

Hasmit e armando arixhiut nga dukati i vlores ujku i dukatit trim mbi trima sa e shikojn njerzit i ze barku bredh me bmv blind ka qen blindi al kapones tani r ka atmanda arixhiu nga dukati me origjin nga elbasani kushuriri i eduart peqinit alias mandela

Përgjigju

Lala: 05/10/2021 08:20

O hasta po tall riken labi se dukato ska arixhinj nejse.sdo kesh qen ndonjeher andej dhe e merr seriozisht.te vetmit gabel we bejn si te fort I ka pas peqini e me thon te drejten atje ndahet kufiri get tosk

Hasta el fuego: 05/10/2021 06:03

Dallohet sa trima ka vlora elbasani e shum qytete te jugut saqe krenoheni me arxhijn per trimeri duhet te ju vjere turp nga vetja qe i keni len me ngrit koken se ne veri arxhijnt veq te shesin rroba te perdorura e te mledhin hekur baker dhe knaqe se per tjeter si kena lan me ngrit kok

Latif: 05/10/2021 00:12

Ik ere loqe

Shkodra: 04/10/2021 19:24

Shum i paskan lan me ec ne kam me gjith keto precedente

Përgjigju

Elbasallu: 04/10/2021 21:33

O shkodra keta per here vete pare hecnin ne kam se rrinin me makin te bliduar. Keshtu qe skan hec shume .

Nana nga elbasani: 04/10/2021 19:05

U bafte nana u baft . Po ketu në ne elbasan nuk hahet vec bollokumja mi nan keta cunat e elbasani qe kan vrare e kan prere jasht shteti ketu ne elbasan do e hajn bollokumen me gjith bollokumin. po u pate shku mendja per thana jeni ketu te nana. Hajd me kam te mar te nana.

Përgjigju

Kosedi: 04/10/2021 19:00

Se di kush e ka bere, por me nje gur ka thyer dy WC

Përgjigju

anonymous: 04/10/2021 18:43

eh sikur te ktheheshe dhe nje her Mond Koseni

Përgjigju

Elbasanlliu: 04/10/2021 17:35

Ah mond koseni vetem ti bone pun ketu. Sa ike ti elbasani nuk gjeti ma derman

Përgjigju

Lajme të tjera

Kronikë



U godit me sende të forta nga klienti, ndërron jetë në spital pas 5 ditësh kamarieri në Elbasan! Sherri nisi për një tavolinë të rezervuar

7 Tetor, 19:47

Kronikë

Elbasan/ Mjeti humbet kontrollin dhe përplaset me shtyllën, 3 persona të plagosur

6 Tetor, 00:24

Kronikë



‘Dëgjuam ulërima’, dëshmitarët rrëfejnë momentin e vrasjes së vajzës ganeze nga i riu shqiptar: Një person i tretë doli nga dhoma

5 Tetor, 14:32

Kronikë

Atentati mafioz në Elbasan, 2 viktimat lëviznin me makina të blinduara! Njëri prej autorëve drejt identifikimit, dyshime të forta për grupin e Dubait

5 Tetor, 10:23

Kronikë

Iu bë atentat mbrëmjen e sotme në Elbasan, Lulzim Bitri lidhje të ngushta me Talo Çelën! Ardian Çollaku i hetuar për vrasjen e Everest Çakaj 6 muaj më parë

4 Tetor, 21:30

Kronikë

I shpallur në kërkim për vrasje të mbetur në tentativë, arrestohet 36-vjeçari në Kavajë

4 Tetor, 12:22

© 2011 - 2021 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje